

Në bazë të Nenit 60 dhe 61 të Statutit dhe në përputhje, Kryesia Qendror e Aletrnativës në mbledhjen e mbajtur më datë \_\_\_\_\_ në Shkup e miratoi këtë :

## **RREGULLORE**

### **E SEKRETARIATIT TË DEPARTAMENTEVE TË ALERTNATIVËS**

#### **I. Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve, organizimin e brendshëm, si dhe emërimin, shkarkimin dhe mbikëqyrjen e drejtorëve dhe anëtarëve të departamenteve të Sekretariatit të Departamenteve si dhe Sekretarit të Sekretariatit të Departamenteve.

#### **II. Përkufizimi i Sekretariatit të Departamenteve**

##### **Neni 2**

Ky sekretariat në përbërje të tij funksionon sipas mënyrës organizative të ministrive të ndryshme në Maqedoni.

Ky sekretariat monitoron punën e Qeverisë dhe organeve të tjera shtetërore sipas sektorëve përkatës dhe jep informata zyrtare, bën përgatitjen e materialeve dhe propozon politikat e Aletrnativës në raport me këto organe.

Ky sekretariat përbëhet nga specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët veprojnë brenda këtij sekretariati sipas profesioneve të caktuara.

#### **III. Drejtorët e departamenteve**

##### **Neni 3**

Të gjitha departamentet nga radhët e tyre zgjedhin Drejtor, i cili do të udhëheqë me punën e departamentit.

Drejtorët e të gjithë departamenteve përbëjnë Sekretariatit të Departamenteve.

Me propozim të Kryetarit të Aletrnativës, Kryesia Qëndrore, me shumicë të thjeshtë të votave të numrit të përgjithshëm, zgjedhin Sekretar të Sekretariatit të Departamenteve, i cili do ta përfaqësojë sekretariatit në të gjitha organet e Aletrnativës.

#### **IV. Sekretariati i Departamenteve**

##### **Neni 4**

Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve bën monitorimin dhe mbikëqyrjen e departamenteve brenda Sekretariatit, jep instruksione dhe mendime, me qëllim që të gjitha aktivitetet dhe punët e departamenteve të jenë në frymën e programit, platformës dhe vizionit të Aletrnativës.

Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve është përgjegjës i të gjitha departamenteve të këtij sekretariati, në çdo kohë ka të drejtë që të stopojë një aktivitet të departamentit të caktuar dhe të kërkojë qëndrim nga Kryesia Qendrore se aktiviteti në fjalë është apo jo në frymën e programit, platformës dhe vizionit të Aletrnativës.

Sekretariati i Departamenteve në organizimin e tij të brendshëm ka disa departamente, si:

- Departamenti i Punëve të Brendshme;
- Departamenti i Punëve të Jashtme;
- Departamenti i Ekonomisë dhe Financa;
- Departamenti i Drejtësisë;
- Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale;
- Departamenti i Shëndetësisë;
- Departamenti i Transportit dhe Lidhjeve;
- Departamenti i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Departamenti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave,
- Departamenti i Kulturës dhe Çështjeve Fetare;
- Departamenti i Mbrojtjes;
- Departamenti i Arsimit, Shkencës, Rinisë dhe Sportit;
- Departamenti i Shoqërisë Informatike dhe Administratës Shtetërore;
- Departamenti i Qeverisjes Lokale.

Ky sekretariat mund të themelojë edhe departamente të tjera sipas nevojës.

#### **Neni 5**

Departamentet përbëhen nga anëtarë të Aleternativës – njerëz kompetentë, profesionistë, specialistë dhe ekspertë të fushave përkatëse, të cilët në bazë vullnetare marrin pjesë dhe kontribuojnë në departamentin përkatës.

Anëtarët e departamenteve propozohen nga të gjitha organet e Aleternativës, deri te Kryesia Qendrore e Aleternativës.

Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të departamenteve vendos Kryesia Qendrore e Aleternativës.

Me propozim të Kryetarit të Aleternativës departamentet nga radhët e veta zgjedhin dhe shkarkojnë Drejtor të Departamentit.

Drejtori i Departamentit për të gjitha aktivitetet e ndërmarra në departamentin që ai e drejton e informon me kohë Sekretarin e Sekretariatit të Departamenteve.

#### **Neni 6**

Drejtori i departamentit gjegjësisht ka të drejtë të angazhojë për çështje të caktuara edhe profesionistë, specialistë dhe ekspertë të fushave përkatëse, të cilët nuk janë anëtarë të Aleternativës.

Angazhimi i tyre bëhet përmes një marrëveshjeje paraprake me shkrim mes departamentit të cilin e përfaqëson Drejtori dhe personi i angazhuar.

Marrëveshja për angazhim parasheh kohëzgjatjen e angazhimit, si dhe të drejtat dhe obligimet e personit të angazhuar në cilësinë e ekspertit të jashtëm.

Për çdo person të jashtëm të angazhuar në cilësinë e profesionistit, specialistit ose ekspertit të fushave përkatëse, Drejtori i departamentit paraprakisht duhet të njoftojë Sekretarin e Sekretariatit të Departamenteve.

#### **IV.1. Departamenti i Punëve të Brendshme**

##### **Neni 7**

Departamenti i Punëve të Brendshme monitoron punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.2. Departamenti i Punëve të Jashtme**

##### **Neni 8**

Departamenti i Punëve të Jashtme e monitoron punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.3. Departamenti i Ekonomisë dhe Financa**

##### **Neni 9**

Departamenti i Ekonomisë monitoron punën e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Ekonomisë, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.5. Departamenti i Drejtësisë**

##### **Neni 10**

Departamenti i Drejtësisë monitoron punën e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Drejtësisë, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

## **IV.6. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale**

### **Neni 11**

Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale monitoron punën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

## **IV.7. Departamenti i Shëndetësisë**

### **Neni 12**

Departamenti i Shëndetësisë monitoron punën e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Shëndetësisë, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

## **IV.8. Departamenti i Transportit dhe Lidhjeve**

### **Neni 13**

Departamenti i Transportit dhe Lidhjeve monitoron punën e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

## **IV.9. Departamenti i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

### **Neni 14**

Departamenti i mjedisit dhe planifikimit hapësinor monitoron punën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.10. Departamenti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave**

##### **Neni 15**

Departamenti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë (menaxhimit) të Ujërave monitoron punën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë (menaxhimit) të Ujërave të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë të Ujërave, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.11. Departamenti i Kulturës dhe Çështjeve Fetare**

##### **Neni 16**

Departamenti i Kulturës dhe Çështjeve Fetare e monitoron punën e Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Kulturës, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.12. Departamenti i Mbrojtjes**

##### **Neni 17**

Departamenti i Mbrojtjes monitoron punën e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së mbrojtjes, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.13. Departamenti i Arsimit, Shkencës, Rinisë dhe Sportit**

##### **Neni 18**

Departamenti i Arsimit, Shkencës, Rinisë dhe Sportit monitoron punën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.14. Departamenti i Shoqërisë Informatike dhe Administratës Shtetërore**

##### **Neni 19**

Departamenti i Shoqërisë Informatike dhe Administratës Shtetërore e monitoron punën e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës Shtetërore të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës Shtetërore, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **IV.15. Departamenti i Qeverisjes Lokale**

##### **Neni 20**

Departamenti i Qeverisjes Lokale monitoron punën e Ministrisë së Qeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë, si dhe të organeve të tjera që ndërlidhen me aktivitetet dhe programet e kësaj ministrie, me qëllim që sa më mirë dhe sa më drejt të zbatohen normat kushtetuese dhe ligjore ndaj qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Ky departament, në bazë të përcjelljes së programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë së Qeverisjes lokale, jep informata dhe propozime konkrete deri te Sekretari i Sekretariatit të Departamenteve, si dhe bën përgatitjen e materialeve të caktuara që ndërlidhen me veprimtarinë e aktiviteteve të kësaj ministrie.

#### **V. Dispozitat e përfundimtare**

##### **Neni 21**

Sekretariati i Departamenteve do të rregullohet me rregullore të veçantë.

##### **Neni 22**

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj nga Kryesia Qendror e Aletnativës

Afrim Gashi, Kryetar

---